



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No.	01 / 2013	
DATA	30.12.2022	
	PRISHTINË - A	

KGJK.nr.521/2022
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Ibrahim Idrizi, gjyqtar në Themelore në Ferizaj, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/17/2022/GJTHF-AD.nr.12/2022, të datës 16.12.2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Ibrahim Idrizi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, (më tutje Këshilli), me datë 28 tetor 2022, ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor me pretendim së Ibrahim Idrizi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor ka konsideruar se subjekti i hetimit me veprimet e tij rreth delegimit të lëndës së evidentuar 2022:0198020, nga Gjykata Themelore Ferizaj në Gjykatën Themelore Pejë, ka rënë ndesh me dispozitat ligjore sipas nenit 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Kjo pasi që subjekti i hetimit disiplinor nuk kishte kërkuar edhe përjashtimin nga komplet lënda e lartcekur në të cilën ka qenë i përfshirë Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, por kishte kërkuat përjashtimin vetëm sa i përket kërkesës për sekuestrim të vilës së me arsyetim se nuk ka nevojë që të bëhet përjashtimi në komplet rreth.

Me tutje, Autoriteti Kompetent ka propozuar që ndaj subjektit të hetimit në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore, t'i shqiptohet njëri nga sanksionet disiplinore adekuate të parapara sipas nenit 7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Kërkesës për fillimin e hetimeve, Autoriteti Kompetent i'a ka bashkangjitur edhe provat e siguruar në atë fazë të procedurës.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.421/2022, të datës 3 nëntor 2022, ka themeluar panelin hetimor për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/17/2022/GJTHF-AD.nr.12/2022. Paneli hetimor me datë 16 dhjetor 2022, i ka paraqitur Këshillit raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Këshilli me 27 dhjetor 2022, ka mbajtur seancë dëgjimore, ku morën pjesë Kryesuesja e panelit hetimor gjyqtarja Vjollca Buzhala dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Ibrahim Idrizi.

Kryesuesja e panelit hetimor në seancën dëgjimore në Këshill deklaroi se bazuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore me datë 30 nëntor 2022, në të cilën ka prezantuar subjekti i hetimit disiplinor gjyqtarin Ibrahim Idrizi. Gjatë kësaj seance dëgjimore subjekti i hetimit disiplinor nuk kishte pranuar pretendimit për shkelje disiplinore të pretenduar nga Autoriteti Kompetent/Nënkryetarja e Gjykatës Themelore në Ferizaj, sa i përket delegimit të lëndës së evidentuar 2022:0198020 nga Gjykata Themelore Ferizaj në Gjykatën Themelore Pejë.

Gjatë seancës dëgjimore, Kryesuesja e panelit hetimor ka deklaruar se gjatë fazës së hetimit, nga nënkryetarja e Gjykatës Themelore Ferizaj, në cilësinë e Autoritetit Kompetent, kanë pranuar kërkesën për pushimin e kësaj procedure disiplinore, me arsyetim se lënda e lartcekur me datë 01 nëntor 2022 është deleguar në Gjykatën Themelore Pejë.

Subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Ibrahim Idrizi parimisht pajtohet me të gjeturat e raportit hetimor, duke konsideruar se kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent ka qenë i ngutshëm sepse ai i kishte ndërmarr veprimet të bazuara në ligj, si kërkesën për përjashtim obligator dhe fakultativ të përcaktuara në nenin 39, paragrafi 1, 2 dhe 3, dhe sipas nenit 40, paragrafi 1, të parapara në Kodin e Procedurë Penale të Republikës së Kosovës. Tutje ka deklaruar se pas pranimit të kërkesës për sekuestrim të villës së kryetarit të Gjykatës Themelore Ferizaj, ka kërkuar menjëherë përjashtim nga lënda kontestuese për pjesën sa i përket vendosjes mbi kërkesën e prokurorit të shtetit mbi sekuestrimin e villës së kryetarit. Po ashtu, i njëjti deklaroi se me datë 01 nëntor 2022, lënda në formë fizike është dorëzuar në Gjykatën Themelore Pejë.

Për të vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli i administroj këto prova: kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor te pranuar prej nënkryetares se Gjykatës Themelore në Ferizaj; E-maili i datës 15.10.2022 i Mustaf Tahiri dërguar Enver Peci dhe Mirlinda Bytyqi- Rexhepi; E-maili i datës 17.10.2022 Enver Peci drejtuar dhe Mirlinda Bytyqi- Rexhepi; E-maili i datës 10.10.2022 i Armend Berisha drejtuar Mirlinda Bytyqi- Rexhepi; E-maili i datës 19.10.2022 nga Mirlinda Bytyqi- Rexhepi drejtuar kryetarëve të gjykatave Themelore; E-maili i datës 19.10.2022 nga Valon Totaj drejtuar Mirlinda Bytyqi- Rexhepi; E-maili i datës 21.10.2022 Armend Berisha drejtuar Mirlinda Bytyqi- Rexhepi; E-maili i datës 21.10.2022 Mirlinda Bytyqi- Rexhepi drejtuar Ibrahim Idrizi; E-maili i datës 24.10.2022 Mirlinda Bytyqi- Rexhepi drejtuar Ibrahim Idrizi; E-maili i datës 25.10.2022 Mirlinda Bytyqi- Rexhepi drejtuar Ibrahim Idrizi; E-maili i datës 25.10.2022 Ibrahim Idrizi drejtuar Mirlinda Bytyqi- Rexhepi; E-maili i datës 25.10.2022 Mirlinda Bytyqi- Rexhepi drejtuar Ibrahim Idrizi; E-maili i dt. 17.10.2022 nga Ibrahim Idrizi për Mirlinda Bytyqi Rexhepi; Kërkesa e Ibrahim Idrizi nr. lëndës 2022:019820 i dt.17.10.2022; Kërkesa Gj.A.nr 300/22 i datës 17.10.2022 dërguar kryetarit të Gjykatës së Apelit; E-maili i datës 21.10.2022 i

Mirlinda Bytyqi Rexhepi drejtuar Ibrahim Idrizi; E-maili i dt 24.10.2022 Ibrahim Idrizi drejtuar i Mirlinda Bytyqi Rexhepi; E-maili i datës 25.10.2022 nga i Mirlinda Bytyqi Rexhepi drejtuar Ibrahim Idrizi; E-maili i datës 25.10.2022 nga Ibrahim Idrizi drejtuar Albert Zogaj; E-maili i dt.25.10.2022 nga Ibrahim Idrizi drejtuar Mirlinda Bytyqi Rexhepi; E-maili i datës 26.10.2022 nga Ibrahim Idrizi drejtuar Valon Totaj dhe përgjigja e datës 27.10.2022; E-maili i datës 28.10.2022 nga Mirlinda Bytyqi Rexhepi drejtuar Ibrahim Idrizi; dhe E-maili i datës. 31.10.2022 nga Ibrahim Idrizi dërguar

Kërkesën e Autoritetit Kompetent për pushim të procedurës disiplinore të datës 3 nëntor 2022; Përgjigjen e subjektit të hetimit disiplinor për panelit hetimor; Transkriptin e panelit hetimor për seancën dëgjimore të mbajtur me datë 30.11.2022 etj.

Nga provat e administruara në seancën dëgjimore në Këshill nuk është vërtetuar se subjekti hetimit, gjyqtari Ibrahim Idrizi, gjatë delegimit të lëndës së evidentuar 2022:0198020 nga Gjykata Themelore Ferizaj në Gjykatën Themelore Pejë ka kryer shkelje disiplinore të pretenduara nga Autoriteti Kompetent/Nënkryetarja e Gjykatës Themelore Ferizaj.

Në këtë rast, Këshilli ka vlerësuar se situata e krijuar në mes të Autoriteti Kompetent dhe subjektit të hetimit ka qenë me shumë paqartësi procedurale sa i përket delegimit të lëndës kontestuese dhe kjo u vërtetua edhe me kërkesën e datës 3 nëntor 2022, për pushimin e procedurës disiplinore nga Autoritetit Kompetent.

Andaj, Këshilli në seancën për këshillim dhe votim konstatoj se subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Ibrahim Idrizi nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, nën paragrafi 2, pikat 2.6 dhe 2.7, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.521/2022, datë: 27 dhjetor 2022

Albert ZOGAJ
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Mirlinda Bytyqi Rexhepi, Nën/Kryetare në Gjykatën Themelore në Ferizaj;
- Ibrahim Idrizi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj.